



VENDIM

K.P.P. 641/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 01.10.2018, shqyrtoi ankesat me:

Objekt:

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së për skualifikimin e ofertës të operatorit ekonomik “Inerti” sh.p.k., në procedurën e prokurimit, “Procedurë e hapur”, me objekt “Rikonstruksion dhe shtesë në godinën e AKBPM-së”, me nr. REF-66335-04-30-2018, me fond limit 144,408,163 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 08.06.2018, nga autoriteti kontraktor Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore.

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së lidhur me kualifikimin e ofertave të operatorëve ekonomik “4A-M” sh.p.k., BOE “A.I.A” sh.p.k. & “Fusha” sh.p.k., “2T” sh.p.k., “Curri” sh.p.k., BOE “Agri-Construction” sh.p.k. & “Company Riviera 2008” sh.p.k., BOE “Ed Konstruksion” sh.p.k. & “Alba Konstruksion” sh.p.k. dhe “Ndërtim Montim Patos” sh.a., në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Ankimues:

Operatori ekonomik “Inerti” sh.p.k.
Adresa: Rr. “5 Maji”, Pallati “Inerti”, Tiranë.

BOE “Bean” sh.p.k. & “Kupa” sh.p.k.
Adresa: Lagjia “Qendër”, pranë shkollës 8 vjecare, Levan, Fier.

Autoriteti Kontraktor:

Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore
Adresa: “Rruga e Dibrës”, nr.359/1, Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorët e çështjes, shqyrtoi parashtimet me shkrim të ankuesve, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I****Vlerësimi paraprak**

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave dhe të dokumentacionit të dërguar nga operatorët ekonomik ankimues dhe autoriteti kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se, mbështetur në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, operatorët ekonomik ankimues kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të. Gjithashut, KPP konstatoi se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.2. Operatorët ekonomik kanë paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe, më pas, kanë paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

I.3. Ankimuesit kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesave të operatorëve ekonomik ankimues.

II**Rrethanat e çështjes**

II.1 Në datën 02.05.2018, në sistemin e prokurimeve elektronike është publikuar procedura e prokurimit, “Procedurë e hapur”, me objekt “Rikonstruktion dhe shtesë në godinën e AKBPM-së”, me nr. REF-66335-04-30-2018, me fond limit 144,408,163 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 08.06.2018, nga autoriteti kontraktor Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore.

II.2 Në datën 08.06.2018, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 26.06.2018, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

1. "Ante-Group" & "Bajrami N" shpk,	93,000,058.00 lekë, Skualifikuar;
2. "Agi Kons" sh.p.k.,	93,423,440.00 lekë, Skualifikuar;
3. "Desaret Company" sh.p.k.,	99,762,353.54 lekë, Skualifikuar;
4. "Inerti" sh.p.k.,	99,832,041.00 lekë, Skualifikuar;
5. "4 A-M" sh.p.k.,	101,167,168.36 lekë, Kualifikuar;
6. "Gjiguria" sh.p.k.,	105,147,000.00 lekë, Skualifikuar;
7. "A.I.A" sh.p.k. & "Fusha" shpk,	105,395,879.40 lekë, Kualifikuar;
8. "Junik" sh.p.k.,	105,417,071.00 lekë, Skualifikuar;
9. "2T" sh.p.k.,	106,638,959.20 lekë, Kualifikuar;
10. "Curri" sh.p.k.,	106,804,476.65 lekë, Kualifikuar;
11. "Agri-Construction" & "Company Riviera 2008" shpk	110,348,791.58 lekë, Kualifikuar;
12. "Kometa 2012" & "Ales Construction" shpk,	116,146,943.05 lekë, Skualifikuar;
13. "Ed Konstruksion" & "Alba Konstruksion" shpk	117,420,925.60 lekë, Kualifikuar;
14. "Be-Is" & "Aurora Konstruksion" shpk,	118,506,620.80 lekë, Skualifikuar;
15. "Ndërtim Montimi Patos" sh.p.k.,	119,470,103.00 lekë, Kualifikuar;
16. "R & T" sh.p.k.,	120,410,750.77 lekë, Skualifikuar;
17. "Bean" sh.p.k., & "Kupa" shpk	121,967,989.00 lekë, Kualifikuar;
18. "Salillari" sh.p.k.,	129,479,310.00 lekë, Skualifikuar;
19. "StarTek" & "Viante Konstruksion" shpk	135,743,618.00 lekë, Skualifikuar;

II.4.Në datën 26.06.2018, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorin ekonomik "Inerti" sh.p.k për skualifikimin e ofertës së tij, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, për arsyet si më poshtë vijon:

1. Nuk plotësoni kriterin e kërkuar në DST në lidhje me pikën: 2.3 Për kapacitetin teknik, pika si vijon: 2. Operatori Ekonomik duhet të ketë numrin e nevojshëm të punonjësve për zbatimin e kontratës. Numri i punonjësve për periudhën Shtator 2017- Shkurt 2018 të jetë mesatarisht 105 punonjës nëmuaj (përfshire dhe stafin jo drejtues teknik-inxhinieri si dhe stafin me certifikatë IQT ose e barazvlefshme), të vërtetuar me; b. List-pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Shtator 2017- Shkurt 2018. Ju nuk përmbushni kriterin e cituar më lart lidhur me numrin e punonjësve- stafin me certifikatë IQT ose e barazvlefshme- të vërtetuar me listëpagesat për periudhën Shtator 2017-Shkurt 2018, për arsye se: punëmarrësi Y. C. – Hidraulik me dëshmi kualifikimi Nr.946 të lëshuar nga EMCO, me kontratë individuale pune të lidhur më datë 01.07.2016 dhe me datë përfundimi 31.12.2018, pasi nuk figuron në listëpagesat Janar – Shkurt 2018.

2. Nuk plotësoni kriterin e DST-ve lidhur me pikën 6. Të ketë brenda stafit të punonjësve të pasqyruar në listëpagesa, punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga IQT ose ekuivalente me të, të vlefshme, minimumi: 3(tre) punonjës hidraulik. Përpunonjesit e sipërpërmendur të paraqiten dëshmitë përkatëse të kualifikimit të sigurimit teknik si dhe kontratat e punës (të vlefshme). Ju nuk keni dorëzuar dokumentacion të rregullt për punonjësit e pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga IQT ose ekuivalente me të, për punonjësit si vijon: Dëshmitë e kualifikimit: 1. Për punonjës K. H. dokumenti i lëshuar nga trupa certifikuese "EMCO" – SSH ISO/IEC 17024: 2012, Rubrika "PROFESIONI" – Hidraulik është i korrigjuar. Kontrata e punës: 1. Kontrata individuale e punës e lidhur midis punëdhënësit "Inerti" shpk dhe punëmarrësit K. H., më datë 05.07.2016, në Nenin 1 "Pëshkrimi i Punës", pozicioni i punës

Hidraulik është i korrigjuar. Nga verifikimi i listëpagesave Shtator 2017 – Shkurt 2018, punëmarrësi K. H. figuron me grupin e profesionit 7117.03, dhe bazuar në VKM nr.627 datë 11.09.2009 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve” Kodi 7117.03 është : “Punëtor izolimi për ndërtesa”. Për pasojë ju nuk plotësoni kriterin për 3-punonjës hidraulik me IQT ose ekuivalente me të.

Arsye III: 2.3 Për kapacitetin teknik, pika si vijon: 9. ”Deklaratë e ofertuesit për modelin, kompaninë prodhuese, vendin e prodhimit për mallrat e paisjet që do të vendosen në objekt sipas tabelës së mëposhtme:”- pasi rezulton se: 1. Keni mospërputhje të deklaramit të bërë në tabelën e plotësuar nga ana juaj për pajisjet, me dokumentacionin e dorëzuar lidhur me: a. Pikën 3, Pikën 4 dhe Pikën 6: ku deklaroni Modelin “Daikin Altherma EHYKOMB-AA” dhe Modelin “EHSXBD”, me Prodhues “DAIKIN” LTD dhe Vend Prodhimi: JAPONI / ITALI, kurse Certifikatat ISO 9001: 2015; ISO 14001:2015 janë lëshuar për kompaninë “DAIKIN EUROPE N.V. Zandvoordestraat 300 8400 Oostende - BELGJIKË”. b. Pikën 2: ku deklaroni Modelin “Calpak” me Prodhues “Klimatëknika/ Midea” dhe Vend Prodhimi KINË / ITALI, me autorizimin e KLIMATEKNIKA TB2 sidhe DEKLARATËN e datës 04 Janar 2018 të lëshuar ng akompania “GD Midea Heating & Ventilating Equipment Co Ltd”-KINË” dhe nuk rezulton të jetë Vend Prodhimi /ITALI. 2. Nuk plotësoni Pikën 8, Pikën 9 dhe Pikën 10 të Deklaratës për Pajisjet ku janë kërkuar shprehimisht: 8. Dere e brendshme importi, 100 x 225cm, hermetike, me njekanate(panel) xhami, me hapje me rreshqitje te panelit , hapje dhe mbyllje te automatizuar me telescopic etj; 9. Derë e jashtme xhami kristal, 2 x 90 x 250, importi, hermetike, me dy Kanata xhami, me vetmbyllje, me hapje dhe mbyllje te kontrolluar dhe autorizuar nga personeli, me kartemagnetike, me doreze etj; 10. Dyer të brendshme importi, 180 x 225cm, hermetike, me dykanata (panelev) xhami, me hapje me rreshqitje te paneleve me sens te kunder tetj; Pasi keni deklaruar Prodhues për të 3 pikat si më lart kompanitë “ILIRIA PLAST/ REHAU” DHE “BIÇAKU” dhe vend prodhimi Itali/Shqipëri, ndërkohë që nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se kompania “EURO-BIÇAKU” sh.p.k. është Prodhues i mirfilltë punimesh dyersh druri, e provuar me Certifikatë ISO 9001:2008, lëshuar nga Certi E”

II.4.1.Në datën 02.07.2018 operatorin ekonomik ankimues “Inerti” sh.p.k. ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

II.4.2.Nga verifikimet e kryera në dokumentacionin e paraqitur pranë KPP, me anë të shkresës Nr. 3875/69 Prot. datë 09.07.2018, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje lidhur me ankesën operatorit ekonomik ankimues “Inerti” sh.p.k, duke e refuzuar atë.

II.4.3.Në datën 12.07.2018 operatori ekonomik ankimues “Inerti” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt me ankesën e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor për procedurën e mësipërme të prokurimit, duke argumentuar si më poshtë vijon:

“[...]Lidhur me sa me sipër. nga dokumentat e paraqitura ne tender, konkretisht vertetim per numrin e te punesuarve sipas periudhes se kerkuar ne DST, konstatohet qe numri mesatar i punetoreve te shoqerise “Inerti” shpk per periudhen Shator 2017-shkurt 2018, e tejkalon shifren 105 punonjes. Madje konkretisht Shoqeria “ Inerti “ Shpk disponon sipas Listapagesave dhe vertetimit nga organet tatimore, dokument bashkangjitur ne dokumentacionin e tenderimit, nje numer mesatar punonjesish 134 te punesuar. Per sa u tha me lart , ky numer i punonjesve te kerkuar nga autoriteti kontrator (105 punonjes mesatarisht) i cili pretendon se ky kriter nuk

permbushet per shkak te mos prezences se nje punetori me deshmi kualifikimi te sigurimit teknik gjate periudhes Janar-Shkurt 2018 nderkohe qe per stafin me deshmi kualifikimi, Autoriteti Kontraktor nuk eshte shprehur specifikisht nese keta punonjes duhet te pasqyroheshin ne listepagesa gjate gjithë periudhes Shkurt 2017-2018. Shoqeria "Inerti" shpk disponon kapacitetin e nevojshem teknik dhe profesional per kryerjen e zerave te punimeve hidraulike nga persona te kualifikuar si hidraulik, sic mund te evidentohet fare mire dhe nga pjestare te stafit te pasqyruar ne listepagesat e saj nen profesionin e hidraulikut duke tejkaluar numrin minimal te kerkuar nga Autoriteti Kontraktor. Duhet theksuar qe kriteret e DST vendosen per te bindur autoritetin kontraktor qe shoqeria e ndertimit eshte e besueshme dhe ka kapacitetin e nevojshem teknik dhe financiar per te realizuar objektin ne fjale. Ne interpretim e kerkeseve te autoritetit kontraktor, konkretisht kriteri lidhur me punonjesit e pajisur me IQT, nuk mund te jete kusht skualifikues kur jemi ne rrethanat qe shoqeria disponon numrin e mjaftueshem te hidraulikeve per te realizuar objektin dhe mbi te gjitha Autoriteti Kontraktor ka kerkuar vetem qe ata te jene te pasqyruar ne listepagesa duke mos specifikuar periudhen kur duhet te evidentohet ky pasqyrim. Per sa me lart nga numri i punonjesve qe disponon shoqeria " Inerti " Shpk, 134 punonjes, jo vetem e ploteson numrin e kerkuar te specialisteve, konkretisht te hidraulikeve qe eshte tre specialiste sipas kerkeses se autoritetit kontraktor por e tejkalon ate, duke disponuar per cdo muaj te kesaj periudhe me me shume specialiste hidraulik, te cilet jane sipas listes me poshte te verifikueshem ne listpagesat e paraqitura ne tender dhe kodit perkates te tyre ne listen e sigurimeve shoqerore. Pra per sa argumentuam nga disponimi i stafit, shoqeria " Inerti " Shpk disponon kapacitetin e specialisteve, gje e cila nuk le te kuptohet qe te njejtet emra te jene nga fillimi e deri ne fund te periudhes, per shkak te levizjes se stafit per specializime te ndryshme ndertimi, kriteri i cili nuk eshte kerkuar nga Autoriteti Kontraktor i shprehur konkretisht ne piken 6 te dokumentave standarte te tenderit ku shprehimisht shkruhet: Te kete brenda stafit te punonjesve te pasqyruar ne listpagesa punonjes te pajisur me deshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga IQT ose ekuivalente me te , te vlefshme minimumi: 3 (tre) punonjes elektricist 3 (tre) punonjes hidraulik 3 (tre) punonjes mekanik 2 (dy) punonjes bojaxhi 2 (dy) punonjes pllakashtrues 2 (dy) Punonjes murator 2 (dy) punonjes saldator. Per punorgjesit e siperpermendur te paraqiten deshmite perkatese te kualifikimit te sigurimit teknik si edhe kontrate pune (te vlefshme). Pra kriteri i siperpermendur, jo vetem permbushet nga shoqeria " Inerti " Shpk por nuk ka as vend per interpretim, sepse nuk eshte shprehur ne asnje rresht apo germe te ketij kriteri qe patjeter ky grup specialistesh duhet te figuroje ne 6 muajt e fundit por eshte kerkuar te jene brenda stafit dhe te figurojne ne listpagesa pa specifikim muajsh. Konkretisht specialisti Y. C. figuron brenda kesaj periudhe kohore te kerkuar nga Autoriteti Kontraktor. Pra shoqeria Inerti kerkon te shikohet edhe nje here nga Komisioni i marrjes ne dorezim te ankesave, aktualisht dhe nga Komisioni i Prokurimit Publik, argumenti per te cilin jemi skualifikuar ne menyre te padrejte dhe joligjore Mungesa e hidraulikut Z.Y. C. në muajin Janar-Mars 2018 nuk ndikon ne kapacitetin e shoqerise per te realizuar punimet hidraulike pasi sic e permendem dhe me siper disponojme 5 hidraulike te tjere ne listepagesat perkatese, te cilet jane konkretisht H. B.; A. T.; B. Ç.; I. K.; H. M.; K. H.; Y. C.; A. A. Pra shoqeria jone i plotesone te gjitha aftesite teknike per realizimin e kontrates ne fjale sic eshte pershkruar ne objektin e kontrates nga Autoriteti Kontraktor pasi vete dokumentacioni financiar, konkretisht listepagesat, vertetojne fare mire numrin e personelit profesional per realizimin e cdo zeri punimesh qofshin keto hidraulike apo te nje lloj tjeter. Gjithashtu shoqeria " "Inerti"" shpk ka ndertuar me prezencen e saj, jo pak por 28 vite ne tregun e ndertimit, reputacion i cili eshte mbeshtetur ne cdo aset teknik dhe human qe kjo shoqeri ka edhe faktin dhe nj ehere aftesite e kesaj shoqerie per realizimin e objektit te kerkuar.

Lidhur me arsyen e dyte te skualifikimit. Ne kriteret e keruara ne DST kerkohej qe punetoret me deshmi kualifikimi te pasqyrohen ne listepagesa dhe kushti ne fjale eshte permbushur plotesisht pasi emri i Z. K. H. rezulton i pasqyruar ne listepagesa. Korrigjimi ne kontraten e punetorit ka qene per nje problem te vogel teknik dhe nuk mund te konsiderohet si shkak pavlefshmerie perderisa ky person aktualisht ushtron profesionin e hidraulikut fakt i cili mund te vertetohet ne cdo kohe nga Autoriteti Kontraktor. Edhe ne kete rast qendron arsyetimi i perdorur ne argumentin paraardhes ku theksuam qe shoqeria "Inerti" shpk i ka te gjitha asetet njerezore per realizimin e zerave te punimit hidraulike pasi disponon nje numer me te madh hidraulikesh se ai i kerkuar ne DST.

Lidhur me arsyen III:

Me shtojcen e bere per kete kriter Autoriteti Kontraktor ka cituar: pika 9.1, 9.2 dhe 9.3 i kerkohet vetem Operatori ekonomik të Shpallur fitues. Ne interpretimin tone, autorizime nga distributoret dhe certifikime ISO kerkohen per piken 9 vetem ne rastet kur OE shpallet fitues. Per cdo pike tjeter, Autorizimet se bashku me Certifikimet Iso jane perdorur si dokument suplementar nga ana jone pasi nuk jane kerkuar nga Autoriteti Kontraktor si pjese e dokumentacionit qe duhet te shoqeroje tabelen. Per te qendruar mbi kete fakt gjithashtu ju sqarojme qe Certifikimi Iso është prova e përputhshmerisë me normativën, e vendosur nga Enti ose Organizata. Certifikimi është nje garanci e shkruar, e lëshuar nga një ent, ose organizatë e huaj, e pavarur, e cila çertifikon një produkt të caktuar, shërbim ose sistem, sipas kërkesave të normës. Ndaj vendi nga i cili ka dale ISO nuk ka lidhje me vendin e prodhimit te paisjeve te kerkuara nga ju, ISO eshte thjesht certifikim i konformitetit te ketyre paisjeve te leshuara per distributori kryesor. Vendin i prodhimit ka qene element deklarativ i kerkuar. Cdo e dhene e paraqitur ne tebelet mund te verifikohet lehtesisht duke kontrolluar faqet zyrtare te distributoreve dhe prodhuesve kryesore ne te cilat evidentohen qartazi elementet e deklaruar ne tabelen respektive.[...]"

II.5.Në datën 07.07.2018 BOE ankimues "Bean" sh.p.k. & "Kupa" sh.p.k. ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për kualifikimin e ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomik "4A-M" sh.p.k., BOE "A.I.A" sh.p.k. & "Fusha" sh.p.k., "2T" sh.p.k., "Curri" sh.p.k., BOE "Agri-Construction" sh.p.k. & "Company Riviera 2008" sh.p.k., BOE "Ed Konstruksion" sh.p.k. & "Alba Konstruksion" sh.p.k. dhe "Ndërtim Montim Patos" sh.a., në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

II.5.1.Nga verifikimet e kryera në dokumentacionin e paraqitur pranë KPP, me anë të shkresës Nr. 3875/75 Prot. datë 10.07.2018, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje lidhur me ankesën BOE ankimues "Bean" sh.p.k. & "Kupa" sh.p.k., duke e refuzuar atë.

II.5.2.Në datën 19.07.2018 BOE ankimues "Bean" sh.p.k. & "Kupa" sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt me ankesën e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor për procedurën e mësipërme të prokurimit, duke argumentuar si më poshtë vijon:

"[...]Operatori ekonomik 4A-M shpk , duhet te skualifikohet mbeshtetur ne nenin 66, pika 4 e VKM, ku citohet se: Ofertat e kualifikuara verifikohen nëse kanë apo jo gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike korrigjohen në mënyrën e mëposhtme: "Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se $\pm 2\%$ e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar "

Nga renditja me cmime qe morrem ne daten e hapjes se procedures me date 08.06.2018 rezultoi se 4 A-M e kishte vlere e ofertes ne shumen prej 1066,868,251.7 leke pa TVSH , ne daten 26.06.2018 ne renditje rezultoi se ky operator e ka vleren 101,167,168.36 leke pa TVSH. Pra 106,868,251.7 -

101,167,168.36 = 2% i ofertes fillestare eshte 2,137,365.02 nderkohe qe diferenca e dale nga korrigjimi i ofertes del 5,701,083 leke, pra eshte qartesisht e dukshme se korrigjimi eshte me i madhe se 2% e vleres se ofertes. Pavaresisht se nga ka derivuar ky gabim ajo qe ka rendesi eshte fakti se ka korrigjim te vleres se ofertes dhe eshte me i madh se 2% . Per sa me siper kerkojme skualifikimin e ofertes se operatorit ekonomik 4A-M shpk.

2. Bashkimi i Operatoreve ekonomik A.I.A & FUSHA shpk duhet te skualifikohet pasi nuk permbush te gjitha kriteret e kerkuara ne Dokumentet Standartete Tenderit dhe kjo vjen ne kundërshtim me Neni 46/1 i ligjit. Konkretisht operatori ekonomik ka keto mangesi : FUSHA ka deklaruar se ka si kontrate te fituar ne vazhdim me vlere prej 1 miliarde, nderkohe qe piken e Licenses profesionale per Rikonstrukcion e ka kategorine F, nderkoh qe e ka kaluar kufirin 100% sepes duhet ta kishte G (mbi 800 milion). AIA kontrata e vetme e vlefshme Brenda afatit 3 vite nga data e tenderit eshte ajo e Ujit te Ftohte e cila ka shtrirje prej 20.06.2010 deri me 27.05.2017, referuar faturave qe perfshihen ne periudhen 3 vjecare vlere arin ne shume prej 17,044,137 leke nderkohe qe sipas perqindjes qe ka mare persiper duhet ta kishte ne vleren prej 23,827,346 leke. Sipas kontrates se bashkepunimit FUSHA ka marre persiper furnizimin me te gjitha pasijet ndersa ne autorizimet e prodhuesit qe jane paraqitur figuron se eshte i autorizuar per keto pasije eshte FUSHA. Per sa me siper kerkoj me te behet rivleresim dhe te skualifikohet ky bashkim operatorësh.

3. Bashkimi i Operatoreve ekonomik AGRI DHE RIVIERA duhet te skualifikohet pasi nuk permbush te gjitha kriteret e kerkuara ne Dokumentet Standarte te Tenderit dhe kjo vjen ne kundërshtim me Neni 46/1 i ligjit. Deklaratën mbi kontratat e lidhura dhe/ ose ne proces te paraqitur nga te dy operatorët ekonomik Agri & Riviera jane shpallur fitues ne procedure e prokurimit MSHMS per rikonstrukcionin e QSH per Lotin 1, pikerisht kjo nuk eshte deklaruar ne kete deklarate pra keta operatore ekonomik kane mashtruar dhe nuk kane bere deklarim te sakte. Per sa me siper kerkoj me te behet rivleresim dhe te skualifikohet ky bashkim operatorësh.

4. ED KONSTRUKSION dhe ALBA Konstruksion, duhet te skualifikohet pasi nuk permbush te gjitha kriteret e kerkuara ne Dokumentet Standarte te Tenderit dhe kjo vjen ne kundërshtim me Neni 46/1 i ligjit. Deklaratën mbi kontratat e lidhura dhe/ ose ne progres te paraqitur nga te operatori ekonomik ED KONSTRUKSION pasi ky operator ka si object Rikonstrukcionin e Shkolles "Servete Maci" pikerisht kjo nuk eshte deklaruar ne kete deklarate pra ky operatore ekonomik ka mashtruar dhe nuk ka bere deklarim te sakte. Per sa me siper kerkojme te behet rivleresim dhe te skualifikohet ky bashkim operatorësh.

5. Operatori Ekonomik CURRI, duhet te skualifikohet pasi nuk permbush te gjitha kriteret e kerkuara ne Dokumentet Standarte te Tenderit dhe kjo vjen ne kundërshtim me Neni 46/1 i ligjit. Vertetimi I OSHES eshte pa perfshire muajin prill 2018 kjo vjen ne kundërshtim me VKM m. 109 dt.21.10.2011 "Per miratimin e kontrates se furnizimit me energji elektrike te klienteve jofamiljar" percaktohet shprehimisht se Klienti do te paguaje detyrimin e percaktuar ne faturen mujore te konsumit te energjise elektrike si dhe kur eshte rasti, jo me vone se ditën e fundit te muajit kalendarik te muajit pasardhes te atij te faturuar." Procedura u zhvillua me date 08.06.2018 dhe muaji prill paguhet Brenda dates 31.05.2018. Nuk disponon ISO 3834-2:2005 Per sa me siper kerkojme te behet rivleresim dhe te skualifikohet ky bashkim operatorësh.

6. Operatori Ekonomik 2T duhet te skualifikohet pasi nuk permbush te gjitha kriteret e kerkuara ne Dokumentet Standartete Tenderit dhe kjo vjen ne kundërshtim me Neni 46/1 i ligjit.

Eskavator për gërmim me kapacitet të kovës 0.25m³ me rrota ose zinxhir. Operatori ekonomik ne dokumentacionit qe ka paraqitur nuk deshmon e kapacitet të kovës 0.25m³. Vinckarel (portativ) i levizshem me kapacitet 0.3 +0.5 ton. Operatori ekonomik ne dokumentacionit qe ka paraqitur nuk deshmon kapacitetin 0.3 +0.5 ton. Për sa më sipër cituam dhe argumentuam kërkojmë heqjen e

këtyre kriterëve diskriminuesë, me qëllim hapjen e konkurrencës së lirë të të gjithë operatorëve ekonomik. 7. Operatori Ekonomik NDERTIME PATOS duhet të skualifikohet pasi nuk përmbush te gjitha kriteret e kerkuara ne Dokumentet Standarte te Tenderit dhe kjo vjen ne kundërshtim me Neni 46/ 1 i ligjit. Mjeti Elektro betoniera ose moto betoniera per pergatitje betoni dhe llaci ne objekt me kapacitet betonieres 0.3 -0.5 m3. Operatori ekonomik nuk ka te percaktuar kapacitetin e betonieres. Mjeti Eskavator për gërmim me kapacitet të kovës 0.25m3 me rrota ose zinxhir Eskavatori nuk ka te percaktuar nese eshte me kove dhe as permasen e koves.[...]"

II.6.Në datën 24.07.2018 dhe 27.07.2018 autoriteti kontraktor me anë të shkresave nr.3875/85prot., datë 20.07.2018 dhe nr.3875/87prot., datë 25.07.2018 ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin e kërkuar në lidhje me procedurën e prokurimit të sipërcituar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dhe kërkesave të operatorëve ekonomik ankimues,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik "Inerti" sh.p.k, mbi skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me arsyen: "[...]2. Nuk plotësoni kriterin e DST-ve lidhur me pikën 6. Të ketë brenda stafit të punonjësve të pasqyruar ne listpagesa, punonjës t ëpajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga IQT ose ekuivalente me të, të vlefshme, minimumi: 3(tre) punonjës hidraulik. Përpunonjesit e sipërpërmendur të paraqiten dëshmitë përkatëse të kualifikimit të sigurimit teknik si dhe kontratat e punës (të vlefshme). Ju nuk keni dorëzuar dokumentacion të rregullt për punonjësit e pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga IQT ose ekuivalente me të, për punonjësit si vijon: Dëshmitë e kualifikimit: 1. Për punonjësin K. H. dokumenti i lëshuar nga trupa certifikuese "EMCO" – SSH ISO/IEC 17024: 2012, Rubrika "PROFESIONI" – Hidraulik është i korrigjuar. Kontrata e punës: 1. Kontrata individuale e punës e lidhur midis punëdhënësit "Inerti" shpk dhe punëmarrësit K. H., më datë 05.07.2016, në Nenin 1 "Pëshkrimi i Punës", pozicioni i punës Hidraulik është i korrigjuar. Nga verifikimi i listëpagesave Shtator 2017 – Shkurt 2018, punëmarrësi K. H. figuron me grupin e profesionit 7117.03, dhe bazuar në VKM nr.627 datë 11.09.2009 "Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve" Kodi 7117.03 është : "Punëtor izolimi për ndërtesa". Për pasojë ju nuk plotësoni kriterin për 3-punonjës hidraulik me IQT ose ekuivalente me të.[...]", Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1.Në shtojcën nr. 12, pika 2.3.6 "Për Kapacitetin Teknik" në dokumentat standarte të tenderit në procedurën e prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

"Të ketë brenda stafit te punonjesve te pasqyruar ne list-pagesa, punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga IQT ose ekuivalente me te, të vlefshme. minimumi:

3(tre) punonjës elektrikist

3(tre) punonjës hidraulik

3 (tre) punonjes mekanik

2 (dy) punonjës bojxhi

2 (dy) punonjës pllakashtrues

2 (dy) punonjës murator

2 (dy) saldatore”

III.1.2. Nga verifikimet e kryera në SPE, rezulton se, në përmbushje të kriterit të sipërcituar, lidhur me punonjësit “Hidraulik”, ankimuesi ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë:

- Kontratë Individuale Pune, lidhur ndërmjet subjektit “Inerti” sh.p.k. në cilësinë e punëdhënësit dhe Z. A. A., në cilësinë e punëmarrësit, shoqëruar me Dëshminë e Kulifikimit për Sigurimin Teknik të Z. A. A.
- Kontratë Individuale Pune, lidhur ndërmjet subjektit “Inerti” sh.p.k. në cilësinë e punëdhënësit dhe Z. Y. C., në cilësinë e punëmarrësit, shoqëruar me Dëshminë e Kulifikimit për Sigurimin Teknik të Z. Y. C.
- Kontratë Individuale Pune, lidhur ndërmjet subjektit “Inerti” sh.p.k. në cilësinë e punëdhënësit dhe Z. K. H., në cilësinë e punëmarrësit, shoqëruar me Dëshminë e Kulifikimit për Sigurimin Teknik të Z. K. H.
- Listpagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi, për periudhën Shtator 2017 – Mars 2018.

III.1.3. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”

III.1.4. Në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 26, pika 8, përcaktohet se: “8. Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose; b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose; c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.”

III.1.5. Referuar dokumentacionit të sipërcituar, të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në përmbushje të kriterit për disponimin e punonjësve me profesion “Hidraulik”, Komisioni konstaton se punonjësi Z. K. H., në kolonën: “Detyra, funksioni, profesioni apo puna që ka kryer punonjësi” të listapagesave të paraqitura, ka kodin 7117.03, i cili, referuar VKM-së nr. 627, datë 11.06.2009 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve”, i korrespondon profesionit “Punëtor izolimi për ndërtesa” dhe jo profesionit “Hidraulik”. Komisioni i Prokurimit Publik thekson se autoriteti kontraktor ka përcaktuar në dokumentat e tenderit objekt ankimi se, operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të vërtetojnë disponueshmërinë e punonjësve duke paraqitur kontratën e punës, dëshminë e kualifikimit të sigurimit teknik përkatës, si dhe të figurojë në listëpagesa. Komisioni

gjykon se operatori ekonomik ankimues “Inerti” sh.p.k., nuk arrin të vërtetojë se punonjësi Z. K. H. është me profesion “Hidraulik”, pasi në listëpagesat e paraqitura, ky i fundit, ka kodin 7117.03, i cili, referuar VKM-së nr. 627, datë 11.06.2009 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve”, i korrespondon profesionit “Punëtor izolimi për ndërtesa” dhe jo profesionit “Hidraulik”, si dhe kontrata e punës dhe dëshmia e kualifikimit të sigurimit teknik nuk janë dokumente të besueshme për të vërtetuar profesionin e punonjësit për shkak të korrigjimeve të kryera. Lidhur me pretendimin e ankimuesit “disponojme 5 hidraulike te tjere ne listepagesat perkatese, te cilet jane konkretisht H. B.; A. T.; B. Ç.; I. K.; H. M.; K. H.; Y. C.; A. A”, Komisioni konstaton se, operatori ekonomik nuk ka paraqitur kontrata pune dhe dëshmitë e kualifikimit të sigurimit teknik për punonjësit e tjerë sipas kërkesave të autoriteti kontraktor në shtojcën nr. 12, pika 2.3.6 “Për Kapacitetin Teknik” në dokumentat standarte të tenderit në procedurën e prokurimit objekt ankimi. Kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Gjithashtu, kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit. Përsa më sipër, operatori ekonomik ankimues nuk e përmbush kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor shtojcën nr. 12, pika 2.3.6 “Për Kapacitetin Teknik”, në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, pasi vërteton disponimin e punonjësve “Hidraulik” sipas përcaktimeve të autoritetit kontraktor vetëm për 2 punonjës nga 3 të kërkuar.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik “Inerti” sh.p.k., nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues “Inerti” sh.p.k. për skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimi i mësipërm nuk qëndron pasi operatori ekonomik ankimues nuk përmbush kriterin e veçantë të kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsyetimit të K.P.P. mbetet e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij operatori ekonomik e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

III.3. Lidhur me pretendimin e BOE ankimues “Bean” sh.p.k. & ”Kupa” sh.p.k., mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Ndërtim Montim Patos” sh.a., në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me argumentin: “[...]Operatori Ekonomik NDERTIME PATOS duhet te skualifikohet pasi nuk permbush te gjitha kriteret e kerkuara ne Dokumentet Standarte te Tenderit dhe kjo vjen ne kundershtim me Neni 46/ 1 i ligjit. Mjeti Elektro betoniera ose moto betoniera per pergatitje betoni dhe llaci ne objekt me kapacitet betonieres 0.3 -0.5 m3. Operatori ekonomik nuk ka te percaktuar kapacitetin e betonieres. Mjeti Eskavator per gërmim me kapacitet të kovës 0.25m3 me rrota ose zinxhir Eskavatori nuk ka te percaktuar nese eshte me kove dhe as permasen e koves. [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik Vëren se:

III.3.1.Në shtojcën nr. 12, pika 2.3.8 “Për Kapacitetin Teknik” në dokumentat standarte të tenderit në procedurën e prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

1. Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që kanë dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (shtojca10)

Mjetet	Sasia	Gjendja
Kamioncine 1-3 ton kapaciteti mbajtes per secilen	2 cope	Pronesi ose qira
Kamioncine 3- 5 ton kapaciteti mbajtes	2 cope	Pronesi ose qira
Kamion per furnizimin me materiale dhe largimin e mbeturinave nga objekti me goma dhe kapacitet mbajtes 5 deri 10 ton dhe vetshkarkues	2cope	Pronësi ose me qira
Autobetoniere	1 cope	Pronesi ose qira
Elektro betoniera ose moto betoniera perper pergatitje betoni dhe llaci ne object me kapacitet te betonieres 0.3 -0.5 m3	1 copë	Pronësi ose me qira
Motogjenerator	1 copë	Pronësi ose me qira
Depozita uji 5.000 lt	1 cope	Pronesi ose me qira
Eskavator për gërmim me kapacitet të kovës 0.25m ³ me rrota ose zinxhir	1 cope	Pronesi ose me qira
Saldatrice	1cope	Pronesi ose qira
Mates energjie 3 fazor dhe panel te vecante, per llogaritjen ne vecanti te konsumit te energjise nga subjekti ndertues	1 cope	Pronesi ose me qira
Vinc kulle metalike + krah horizontal me karel te levizshem horizontal me lartesi te kullës nga toka e sistemuar 20 M dhe krah horizontal me gjatesi min. 15m dhe kapacitet ngrites 0.5÷1 ton	1 cope	Pronesi ose me qira
Vinc karel (portativ) i levizshem me kapacitet 0.3 ÷0.5 ton	1 cope	Pronesi ose me qira
Vibrator per betonim strukturash B/arme	1 cope	Pronesi ose me qira
matrapik	2 cope	Pronesi ose qira
Pompe suvatimi	2 cope	Pronesi ose me qira

Për të dëshmuar këtë, Formulari i shtojcës 10 të DST duhet të shoqërohet me dokumentet e mëposhtme:

- Për mjetet, nëse janë në pronësi duhet të paraqiten faturat e blerjes ose të zhdoganimit të tyre.

- Për mjetet, nëse janë me qera, duhet të paraqiten kontratat e qerave ku afati i marrjes me qera të mbulojë afatin e përfundimit të punimeve të objektit dhe faturat e blerjes ose të zhdoganimit të tyre.
- Për mjetet që shënohen në regjistra publike, nëse janë në pronësi, duhet paraqitur dokumenti që vërteton regjistrimin (leje qarkullimi), certifikatën e kontrollit teknik, policën e sigurimit vjetor.
- Për mjetet që shënohen në regjistra publike, nëse janë me qera, duhet paraqitur dokumenti që vërteton regjistrimin (leje qarkullimi), certifikatën e kontrollit teknik, policën e sigurimit vjetor, dhe kontrata e qerasë e cila duhet të mbulojë afatin e përfundimit të punimeve të objektit.

III.3.2.Në shtojcën “Për modifikimin e dokumentave të tenderit DST me objekt: "Rikonstruksion dhe shtesë në godinën e AKBPM-së”, autoriteti kontraktor ka bërë ndryshimet si më poshtë vijon:

“Ishte

8. Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që kanë dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (shtojca10)

Mjetet	Sasia	Gjendja
Kamioncine 1-3 ton kapaciteti mbajtes per secilen	2 cope	Pronesi ose qira
Kamioncine 3- 5 ton kapaciteti mbajtes	2 cope	Pronesi ose qira
Kamion per furnizimin me materiale dhe largimin e mbeturinave nga objekti me goma dhe kapacitet mbajtes 5 deri 10 ton dhe vetshkarkues	2cope	Pronësi ose me qira
Autobetoniere	1 cope	Pronesi ose qira
Elektro betoniera ose moto betoniera perper pergatitje betoni dhe llaci ne object me kapacitet te betonieres 0.3 -0.5 m3	1 copë	Pronësi ose me qira
Motogjenerator	1 copë	Pronësi ose me qira
Depozita uji 5.000 lt	1 cope	Pronesi ose me qira
Eskavator për gërmim me kapacitet të kovës 0.25m ³ me rrota ose zinxhir	1 cope	Pronesi ose me qira
Saldatrice	1cope	Pronesi ose qira
Mates energjie 3 fazor dhe panel te vecante, per llogaritjen ne vecanti te konsumit te energjise nga subjekti ndertues	1 cope	Pronesi ose me qira
Vinc kulle metalike + krah horizontal me karel te levizshem horizontal me lartesi te kullës nga toka e sistemuar 20 M dhe krah horizontal me gjatesi min. 15m dhe kapacitet ngrites 0.5÷1 ton	1 cope	Pronesi ose me qira
Vinc karel (portativ) i levizshem me kapacitet 0.3 ÷0.5 ton	1 cope	Pronesi ose me qira

Vibrator per betonim strukturash B/arme	1 cope	Pronesi ose me qira
matrapik	2 cope	Pronesi ose qira
Pompe suvatimi	2 cope	Pronesi ose me qira

Për të dëshmuar këtë, Formulari i shtojcës 10 të DST duhet të shoqërohet me dokumentet e mëposhtme:

- Për mjetet, nëse janë në pronësi duhet të paraqiten faturat e blerjes ose të zhdoganimit të tyre.
- Për mjetet, nëse janë me qera, duhet të paraqiten kontratat e qerave ku afati i marrjes me qera të mbulojë afatin e përfundimit të punimeve të objektit dhe faturat e blerjes ose të zhdoganimit të tyre.
- Për mjetet që shënohen në regjistra publike, nëse janë në pronësi, duhet paraqitur dokumenti që vërteton regjistrimin (leje qarkullimi), certifikatën e kontrollit teknik, policën e sigurimit vjetor.
- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, nëse janë me qera, duhet paraqitur dokumenti që vërteton regjistrimin (leje qarkullimi), certifikatën e kontrollit teknik, policën e sigurimit vjetor, dhe kontrata e qerasë e cila duhet të mbulojë afatin e përfundimit të punimeve të objektit.

BËHET

8. Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që kanë dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (shtojca10)

Mjetet	Sasia	Gjendja
Kamioncine DERI 5 ton kapaciteti mbajtes per secilen	4 cope	Pronesi ose qira
Kamion per furnizimin me materiale dhe largimin e mbeturinave nga objekti me goma dhe kapacitet mbajtes 5 deri 10 ton dhe vetshkarkues	2cope	Pronësi ose me qira
Autobetoniere	1 cope	Pronesi ose qira
Elektro betoniera ose moto betoniera perper pergatitje betoni dhe llaci ne object me kapacitet te betonieres 0.3 -0.5 m3	1 copë	Pronësi ose me qira
Motogjenerator	1 copë	Pronësi ose me qira
Depozita uji 5.000 lt	1 cope	Pronesi ose me qira
Eskavator për gërmim me kapacitet të kovës 0.25m³ me rrota ose zinxhir	1 cope	Pronesi ose me qira
Saldatrice	1cope	Pronesi ose qira
Mates energjie 3 fazor dhe panel te vecante, per llogaritjen ne vecanti te konsumit te energjise nga subjekti ndertues	1 cope	Pronesi ose me qira
Vinc karel (portativ) i levizshem me kapacitet 0.3 ÷0.5 ton	1 cope	Pronesi ose me qira
Vibrator per betonim strukturash B/arme	1 cope	Pronesi ose me qira

matrapik	2 cope	Pronesi ose qira
Pompe suvatimi	2 cope	Pronesi ose me qira

Për të dëshmuar këtë, Formulari i shtojcës 10 të DST duhet të shoqërohet me dokumentet e mëposhtme:

- Për mjetet, nëse janë në pronësi duhet të paraqiten faturat e blerjes ose të zhdoganimit të tyre.
- Për mjetet, nëse janë me qera, duhet të paraqiten kontratat e qerave ku afati i marrjes me qera të mbulojë afatin e përfundimit të punimeve të objektit dhe faturat e blerjes ose të zhdoganimit të tyre.
- Për mjetet që shënohen në regjistra publike, nëse janë në pronësi, duhet paraqitur dokumenti që vërteton regjistrimin (leje qarkullimi), certifikatën e kontrollit teknik, policën e sigurimit vjetor.
- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, nëse janë me qera, duhet paraqitur dokumenti që vërteton regjistrimin (leje qarkullimi), certifikatën e kontrollit teknik, policën e sigurimit vjetor, dhe kontrata e qerasë e cila duhet të mbulojë afatin e përfundimit të punimeve të objektit.”

III.3.3.Nga verifikimet e kryera në SPE, rezulton se, në përmbushje të kriterit të sipërcituar, ndër të tjera, operatori ekonomik “Ndërtim Montim Patos” sh.a. ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë:

- Shtojcën 10 “Mbi disponimin e makinerive”.
- Faturë tatimore shitje nr.40145438.
- Kontratë Qeraje, fature tatimore shitje dhe deklaratë doganore për eskavator Cat 325BLN.

III.3.4.Në nenin 53/3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar përcakohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.”

III.3.5. Ndërsa në nenin 55, pika 2 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, është përcaktuar shprehimisht: “2. Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit.”

III.3.6.Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “Ndërtim Montim Patos” sh.a, në mënyrë elektronike, nëpërmjet Sistemit të Prokurimeve Elektronike, KPP konstaton se, në përmbushje të kriterëve të vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit objekt shqyrtimi, lidhur me disponueshmërinë e “1 Eskavator për gërmim me kapacitet të kovës 0.25m³ me rrota ose zinxhir”, ky i fundit ka paraqitur, dokumentacion për 1 eskavator me zinxhir i cili është paraqitur me dokumentacion ku specifikohet modeli i tij. Komisioni gjykon se, në këtë rast, dokumentacioni i dorëzuar e bën lehtësisht të provueshme dhe të verifikueshme kapacitetin e kovës të këtij eskavatori. Ndërsa lidhur me disponueshmërinë e “Elektro betoniera ose moto betoniera per pergatitje betoni dhe llaci ne object me kapacitet te betonieres 0.3 -0.5 m³”, operatori ekonomik “Ndërtim Montim Patos” sh.a, ka paraqitur faturë tatimore shitje nr.40145438,

me anë të së cilës ky i fundit ndër të tjera ka blerë 4 betoniere. Komisioni thekson se në dokumentat e tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, autoriteti kontraktor nuk ka përcaktuar dokumentacionin konkretë me anë të të cilit duhet të vërtetohet kapaciteti i makinerive dhe pajisjeve që kërkohen. Komisioni gjykon se është me vend të theksojë se autoriteti kontraktor gëzon të drejtën e verifikimit në terren në cdo kohë të makinerive dhe pajisjeve të deklaruar nga ofertuesit nëpërmjet shtojcës 10, si gjatë procesit të vlerësimit të ofertave edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në këto kushte, Komisioni gjykon se skualifikimi i operatorit ekonomik “Ndërtim Montim Patos” sh.a bazuar në pretendimet e BOE ankimues, do të ishte në kundërshtim me nenin 55, pika 2 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

III.3.7. K.P.P. gjykon se në rast se BOE ankimues do të kishte pretendime në lidhje me kërkesën e mësipërme të autoritetit kontraktor, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës mbi hartimin e dokumenteve dhe kriterëve të veçanta të kualifikimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP. Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se “Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni”.

Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së. Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se “[...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]”.

Sa më sipër, pretendimet e BOE “Bean” sh.p.k. & ”Kupa” sh.p.k. nuk qëndrojnë.

III.4.Lidhur me pretendimet e BOE ankimues “Bean” sh.p.k. & ”Kupa” sh.p.k. ndaj vendimit të KVO-së për kualifikimin e ofertave të operatorëve ekonomik “4A-M” sh.p.k., BOE “A.I.A” sh.p.k. & “Fusha” sh.p.k., “Curri” sh.p.k., BOE “Agri-Construction” sh.p.k. & “Company Riviera 2008” sh.p.k., BOE “Ed Konstruksion” sh.p.k. & “Alba Konstruksion” sh.p.k. dhe “2T” sh.p.k., në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimet e mësipërme nuk qëndrojnë, pasi operatori ekonomik “Ndërtim Montim Patos” sh.a. përmbush kriteret e kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsyetimit të K.P.P. do të

mbetet e kualifikuar, trajtimi i pretendimeve të ankimuesit në lidhje me kualifikimin e operatorëve ekonomik “4A-M” sh.p.k., BOE “A.I.A” sh.p.k. & “Fusha” sh.p.k., “Curri” sh.p.k., BOE “Agri-Construction” sh.p.k. & “Company Riviera 2008” sh.p.k., BOE “Ed Konstruksion” sh.p.k. & “Alba Konstruksion” sh.p.k. dhe “2T” sh.p.k., nuk ka ndikim mbi fatin e çështjes, pasi bazuar në legjislacionin në fuqi për prokurimin publik, interesi i ligjshëm i drejtpërdrejtë i ankimuesit, nuk ka sesi të dëmtohet nga suksesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në këtë procedurë prokurimi, pasi edhe në hipotezën që këto pretendime do të pranoheshin, ai sërish nuk do të mund të shpallej fitues i kontratës objekt prokurimi, duke qënë se në renditjen përfundimtare, para tij qëndron një tjetër operator ekonomik i kualifikuar.

Në këto kushte, KPP gjykon që pretendimet e ankimuesit nuk do të merren në shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Inerti” sh.p.k, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me objekt “Rikonstruksion dhe shtesë në godinën e AKBPM-së”, me nr. REF-66335-04-30-2018, me fond limit 144,408,163 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 08.06.2018, nga autoriteti kontraktor Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore.
2. Të mos pranojë ankesën e BOE “Bean” sh.p.k. & “Kupa” sh.p.k. për procedurën e prokurimit të sipërcituar.
3. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit të sipërcituar.
4. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1254 protokoli Datë 12.07.2018; Nr. 1284 protokoli Datë 27.07.2018;

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha